



BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE

(Pasqyra 14 Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

MARS, 2019

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Të dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin mars janë të dhënat e raportuara nga të 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit mars 2019 zënë 24 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me ane të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 163.03/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohe që në nivel kombëtar toksikoinfeksionet alimentare paraqesin një incidencë 4.61/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës dhe Kavajë mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike

Rrethi i Shkodrës vazhdon të mbajë peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin mars me 26 raste (1.56/10.000 banore) të konfirmuara dhe dy raste të dyshuara janë raportuar nga rrethet Kukës dhe Dibër.

Janë raportuar 24 raste me Shigeloze përkatësisht 21 raste (1.26/10.000 banore) nga rrethi Shkodër, 2 raste të dyshuara nga rrethi Krujë dhe një rast i dyshuar nga rrethi Lezhë.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin Mars, 2019

(Incidenca raste/100.000 banore)


	Raste, Mars 2019	Incidenca Mars 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	28	1
Shigeloze (Disenteri bacilare)	24	0.86
Dizenteri amebike	0	0

Toksikoinfeksione alimentare	129	4.61
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	4384	156.56
Semundje diarreike ne total	4565	163.03


2. Sëmundjet e EPI

2.1. Fruthi

Gjatë muajit mars 2019 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 258 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 119 raste. Nga këto 43 (36.1%) e rasteve i përkasin rrethit të Tiranës. 34.5 % e rasteve të konfirmuara i përkasin kryesisht grupmoshës < 2 vjeç (41 raste) . Gjatë muajit Mars vërehet një rritje e rasteve me Fruth. Një informacion më të zgjeruar ju mund ta gjeni në “Buletinin Javor të Fruthit”, në website e ISHP.



Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Mars 2019.



Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Mars 2018

Ne muajin Mars të një viti më parë, 2018 u raportuan në total 582 raste prej të vileve 340 u konfirmuan. Nga këto 184 raste ose 54% i përkisnin rrethit të Tiranës. 21.5% ose 73 raste i përkisnin grupmoshës 16-20 vjeç dhe 72 raste ose 21.2% nën 2 vjeç.

Sik shihet në krahasim për të njëjtën periudhë me një vit më parë, numri i rasteve është në rënie dhe grupmoshat < 2 vjeç vazhdon të jetë grupmosha më e prekur. Kjo për shkak edhe të mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës të mëparshëm të tyre në shërbimin pediatrik QSUT.

Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, në ISHP.

2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit mars 2019 janë raportuar 26 raste të reja me TB. Incidenca e TB 0.9/100.000 banorë. Nga rastet e konfirmuara me TB rezulton se 18 raste (69%) janë TB pulmonar dhe 8 raste ose (31%) të formës ekstrapulmonare. Rastet me TB pulmonar të konfirmuar bakteriologjikisht janë 12 raste me sputum pozitiv dhe 6 raste rezultojnë me sputum negativ. Rastet pulmonare sputum pozitiv janë në rrethet: 3 raste në Lushnjë, 3 raste në Tiranë, 2 raste sputum pozitiv në Durrës, 1 rast në Mat, 2 raste në Pogradec, 1 rast në Shkodër. Rastet e raportuara me tuberkuloz pulmonar negativ 6 raste dhe janë: 2 nga Tirana, 1 Mirdita, 1 rast Lezha, 1 rast Elbasani dhe 1 rast nga Dibra.

Rastet TB ekstrapulmonare janë 8 dhe përkatësisht “2 raste ne Mat, nga 1 rast ne Berat, 1 rast ne Bulqizë, 1 rast ne Elbasan, 1 rast ne Kukës, 1 rast ne Pogradec dhe 1 ne Tirane. Format ekstrapulmonare janë : 3 raste pleurite TB , 3 raste versamente pleurale TB, 1 rast limfoadenit TB, 1 rast spondilit TB.


Mosha mesatare e rasteve me TB është 41.5 vjeç (min 10 vjeç – max 72 vjeç). Raste dominojnë te jene ne moshat e reja. Persa i përket gjinisë raporti M; F 2:1. Rastet me TB te konfirmuar ne Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” janë 14 raste ose 53% dhe 12 raste ose 47 % e rasteve janë konfirmuar nga dispanseritë

Vihet re se konfirmimi i rasteve me TB nga dispanserite ne muajin mars është rritur krahasuar me muajin shkurt ku nr i rasteve te konfirmuar nga dispanseritë ishte 30% . Rastet me TB te shtruar ne këtë spital janë testuar dhe për sëmundjen e HIV.

17 raste TB ose (67%) jane nga zonat urbane dhe 9 raste me TB ose (33 %) janë nga zonat rurale

Krahasuar me muajin shkurt vihet te re një rritje e numrit te rasteve me TB nga 18 ne muajin shkurt ne 26 raste ne muajin mars.

:



Grafiku 3: Shpërndarja e rasteve me TB sipas rretheve për muajin mars 2019

3. Zoonozat

Gjatë muajit mars me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh janë raportuar ne nivel vendi shtate raste me bruceloze dhe gjashte raste janë te konfirmuar. Rastet janë raportuar nga rrethi Tepelene (4 raste) dhe përkatësisht nga një rast Kuçova, Kolonja dhe Fieri. Rastet janë: 4 meshkuj te grupmoshës 65 + vjeç, një mashkull 50-54 vjeç dhe dy femra te grupmoshave 40-44 vjeç dhe 30-34 vjeç.

Gjate muajit mars është raportuar një rast i konfirmuar nga Elbasani, mashkull, 65 + vjeç, me Leptospiroze.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Mars 2019
(Incidenca raste/100.000 banore)**

	Raste, Mars 2019	Incidenca Mars 2019 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	7	0.25
Leptospirozë	1	0.04
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit mars 2019 janë raportuar ne total 15 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.54/100.000 banore) nga te cilat 5 raste janë Hepatite virale të paspecifikuar, dhe 10 raste Hepatit virale B te konfirmuara.

Ne lidhje me HBV, 10 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga rrethi Tirane (0.06/10.000 banore), Peqin (1.15/10.000 banore), Fier (0.12/10.000 banore) dhe Vlore (0.08/10.000 banore).

Rastet me Hepatit viral B i përkasin grupmoshës se rritur përkatësisht nga 4 raste grupmosha 40-44 vjeç, 2 raste grupmosha 50-54 vjeç dhe përkatësisht nga një rast 25-29, 55-59 vjeç dhe 60-64 vjeç dhe 65 + vjeç.

Duhet te theksojmë qe laboratorët nuk raportojnë ne lidhje me testimet për Hepatitin B

5. HIV/AIDS

Gjatë muajit Mars 2019 janë kryer 52 ekzaminime me testin ELISA HIV 1+2 Ag/Ab. Nga këto testime, 14 prej tyre kanë rezultuar HIV pozitive. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve pozitive është 9 meshkuj dhe 5 femra. Shpërndarja gjeografike e tyre tregon se 4 raste i përkasin vendbanimit Tiranë, 3 Vlore, 3 Berat, 2 Elbasan, përkatësisht nga një rast kane Saranda dhe Librazhdi, një rast i panjohur. Shpërndarja sipas grupmoshave është 24-59 vjeç.

Grupmoshat më të prekura në muajin Mars janë 25-44 vjeç (5 raste) dhe grupmosha 55-64 vjeç (5 raste), ndërsa grupmosha 16-24 vjeç haset me dy raste, grupmosha 0-15 vjeç me 1 rast (transmetim nga nëna te fëmija) dhe grupmosha 45-54 vjeç me 1 rast. Mostrat e rasteve pozitive janë refereruar nga këto institucione: 4 raste nga infektivi; 3 raste ndjekje epidemiologjike (një në Vlorë dhe 2 raste në Berat); 2 raste nga laboratorit mikrobiologjik i DRSH-së Vlorë; 1 rast nga Sanatoriumi; 1 rast nga burgu dhe 2 raste nga laboratorë privat.

6. Gripi

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se në muajin Mars 2019 aktiviteti i tyre paraqet prirje në rënie ndërsa aktivitetit i gripit **është regjional dhe me intensitet të ulët, me mbizotërim të qarkullimit të virusit të tipit A, nëntipi A/H1 pdm09**. Një informacion me te zgjeruar ju mund ta gjeni në “Buletinin Javor të Gripit”, në website e ISHP.

7. Ethe hemorragjike

Gjatë muajit Mars 2019 janë raportuar 2 raste të dyshuara me ethe hemorragjike. Pas hetimit epidemiologjik të rasteve dhe kartelizimit të tyre në QSUT, Shërbimi i sëmundjeve infektive u vu re se rastet kanë patur një shpërndarje gjeografike përkatësisht 1 rast në Tiranë dhe një rast në Dibër, meshkuj, rasti i parë i papunë ndërsa rasti i dytë blegtor, të grup moshës 25-44 vjeç dhe 45-59 vjeç. Pas marrjes së mostrave serike sipas protokollit të ndjekjes së rasteve të dyshuara me ethe hemorragjike, mostrat u testuan në laboratorin e virologjisë pranë ISHP, nga ku asnjë rast nuk rezultoi pozitiv për ethe hemorragjike.

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI